



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2818/7 prot

Datë 14.12.2023

V E N D I M

Nr. 1295/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2023 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83193-10-11-2023, me objekt: “*Sherbim fiskalizimi*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder me adresë: Lagjia 3 Heronjte, rruga Marin Biçikemi, Shkoder

Ankimues:

“Nexia AI Consulting” SHPK, me NUIS L82210031Q, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Ei3 Software Solution” SHPK me NIPT L62221018T, me adresë: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Robert Shvarc, Nd.15, Nr.Pasurie 6/817-D, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.10.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-83193-10-11-2023, me objekt: “Sherbim fiskalizimi” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

II.2. Në datën 01.11.2023, operatori ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij si më poshtë:

1. “Nexia AI Consulting” SHPK 792,000 lekë pa TVSH, skualifikuar
2. “Kreatx” SHPK 950,000 lekë pa TVSH, skualifikuar
3. “Ei3 Softëare Solution” SHPK 1,200,000 lekë pa TVSH, kualifikuar

Operatori ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

Referuar pikës 2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet te paraqese furnizime te meparshem te ngjashem me vlere me te madhe ose te barabarte se 20% e fondit limit objekt prokurimi.

Referuar pikës 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programme Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. **Gjithashtu mund** të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operoret Ekonomikë ka paraqitur nje autorizim prodhuesi per programin J- Billing ndryshe nga ajo qe kemi kerkuar . Pasi ne kemi kerkuar fiskalizimin e faturave dhe integrim me sistemin faturimit Al- Billing.”

II.3. Në datën 09.11.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 15.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2818/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3605 e operatorit ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-83193-10-11-2023, me objekt: “Sherbim fiskalizimi” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Nexia Al Consulting” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Në DST, në shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik, është kërkuar:

2.3.1 Furnizime te mëparshme te ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Referuar fondit limit prej 1.5 mln lekë, vlera e furnizimeve të mëparshme të ngjashme prej 20% rezulton të jetë 300.000 lekë. Për të plotësuar këtë kriter në kemi ngarkuar në SPE të APP kontratat/vërtetimet me emjntet publike si më poshtë:

1. Vërtetimin e realizimit të kontratës dhe kontratën me shoqërinë e Ujësjetllës Kanalizimeve Vau i Dejës SH.A për kontratën me objekt: “Softëare Fiskalizimi”, datë 09.02.2022 dhe vlerë 98.154,26 lekë pa TVSH
2. Vërtetimin e realizimit të kontratës dhe kontratën me shoqërinë e Ujësjetllës Kanalizimeve Fier SHA për kontratën nr.2764/2 prot., datë 26.11.2021 me objekt: “Shërbim fiskalizimi”, datë 09.02.2022 dhe vlerë 299.000 lekë pa TVSH.

Pra vlera e kontratave të ngjashme të ngarkuara nga ne është 397.154,26 lekë pa TVSH që rezultontë jetë më e madhe se limiti minimal prej 300.000 lekë vendosur nga AK. Të dy furnizimet më sipër, janë jo vetëm të ngjashme por mund të themi të njëjta me objektin e prokurimit.

Në DST, në shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, 2.3.3 Kapaciteti teknik, është kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "AL-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA për kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. **Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing”.**

Për të plotësuar këtë kriter dhe referuar termit “ose ekuivalent” vendosur nga AK me të drejtë, bazuar në përcaktimet ligjore, ne kemi ngarkuar në SPE të APP-së Autorizimin e Prodhuesit të datës 18.10.2023 për programin kompjuterik të faturimit J-Billing, rregjistruar pranë ZSHDA-së me nr. 57 RDA për kategorinë e veprës “Programe kompjuterike”, neni 7/A, si dhe të gjithë dokumentacionin plotësues të tij, lëshuar nga titullari i të drejtave ekskluzive të programit kompjuterik të faturimit J-Billing dhe që i referohet procedurës REF-83193-10-11-2023. Programi kompjuterik J-Billing është një version i përmirësuar i programit AL-Billing, i zhvilluar nga një prej autorëve të këtij të fundit dhe ka qënë e është në përdorim nga disa shoqëri ujësjetllës-kanalizime në vendin tonë dhe si i tillë plotëson kriterin ekuivalent.[...].”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2818/2 date 16.11.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.6. Në datën 30.11.2023, nëpërmjet shkresës me nr. 2818/3 prot., me objekt: “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK*”, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së lartpërmendur.

II.7. Në datën 11.12.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2818/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 2205/1 prot., datë 06.12.2023, me objekt: “*Informacion në lidhje me shkresën nr. 2818/3 prot., datë 30.11.2023*”, me anë të cilës autoriteti kontraktor bën me dije Komisionin e Prokurimit Publik se ankesa nuk është shqyrtuar për arsye të mungesës së personelit të specializuar

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK, **Referuar pikës 2.3.1** *Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:*

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të*

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b)** *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime të mëparshme të ngjashme me vlerë me të madhe ose të barabartë se 20% e fondit limit objekt prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1. të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a)** *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- b)** *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është kërkuar si vijon:

Të dhëna teknike për programin dhe shërbimin e kërkuar:

- a)** *Të regjistruar shpejt dhe lehtë dokumentacionin ku përfshihen faturat elektronike, faturat pa para në dorë, faturat me para në dorë, faturat shoqeruese dhe veprimet e arkave.*
- b)** *Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Al-Billing që është në përdorim nga UK Sh.a. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi i faturimit dhe të fiskalizohen.*
- c)** *Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e faturimit Al-Billing, si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.*
- d)** *Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Al-Billing që është në përdorim nga UK Sh.a për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për arketimet e faturave.*
- e)** *Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.*
- f)** *Pavarësisht numrit të faturave shërbimi duhet të ofrohet për një periudhë 1 vjetecare.*

Operatori ekonomik duhet:

Të ketë zgjidhjen e certifikuar të softëare-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- a. krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;*
- b. vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;*
- c. dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;*
- d. lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;*
- e. transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit*
- f. konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;*
- g. ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;*
- h. gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);*
- i. gjenerimin e kodit QR;*
- j. printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;*
- k. sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;*

III.1.3. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

1. Marrëveshje shërbimi për softëare fiskalizimi, e lidhur në datën 09.02.2022 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Vau i Dejës SH.A dhe operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK me vlerë 98.154,26 lekë pa TVSH. Kjo kontratë është shoqëruar me Vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës “Shërbim fiskalizimi”, me datë 09.02.2022 dhe vlerë 98.154,26 lekë pa TVSH.
2. Kontratë shërbimi nr. 023/2021 e lidhur në datën 26.11.2021 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Fier SHA dhe operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK me objekt: “Shërbim fiskalizimi”, dhe vlerë 299.000 lekë pa TVSH, shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të kësaj kontrate.

III.1.4. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si

dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.1.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: “ 3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe

dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit u ka kërkuar operatorëve ekonomikë, të paraqesin *Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates*, që i korrespondon vlera 300.000 lekë pa TVSh. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në SPE dy kontrata të shoqëruar me vërtetimet e realizimit për secilën prej tyre dhe konkretisht është paraqitur kontrata e shërbimit për softëare fiskalizimi, e lidhur në datën 09.02.2022 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Vau i Dejës SH.A dhe operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK me vlerë 98.154,26 lekë pa TVSH, shoqëruar vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës, si dhe Kontratën e shërbimit nr. 023/2021 e lidhur në datën 26.11.2021 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Fier SHA dhe operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK me objekt: *“Shërbim fiskalizimi”*, dhe vlerë 299.000 lekë pa TVSH, shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të kësaj kontrate.

Në arsyet e dhena nga autoriteti kontraktor rreth mosplotësimit të kriterit të mësipërm nga ana e shoqërisë “Nexia AI Consulting” SHPK, nuk parashtrohet asnjë argument konkret për të justifikuar këtë gjykim, ndërkohë që ky i fundit ka paraqitur dy eksperiencat të mëparshme të cilat kanë si objekt të tyre shërbimin e fiskalizimit në shoqëri Ujësjetllës Kanalizime të cilat kryejnë të njëjtin aktivitet sikurse edhe autoriteti kontraktor në fjalë. KPP sqaron se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kontekst operatori ekonomik ankimues ka paraqitur kontrata të ngjashme, të cilat janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës si më sipër cituar, dhe provojnë në mënyrë të plotë kërkesat që i nevojiten autoritetit kontraktor lidhur me eksperiencat e ngjashme të mëparshme e realizimin me sukses të tyre, si nga vlera e kontratave ashtu edhe nga përmbajtja e tyre.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK se: **“Referuar pikës 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik “AL-Billing”, sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për “Programin kompjuterik AL-Billing”.**

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik ka paraqitur nje autorizim prodhuesi per programin J- Billing ndryshe nga ajo qe kemi kerkuar, pasi ne kemi kerkuar fiskalizimin e faturave dhe integrim me sistemin e faturimit Al- Billing”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3. e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të sipërcitur, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Autorizim prodhuesi me datë 18.10.2023 lëshuar nga kompania “Primus Albania” SHPK për objektin e prokurimit: “Shërbim fiskalizimi” me nr ref- 83193-10-11-2023, drejtuar Shoqërisë Rajinale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkofër SHA, me përmbajtjen si vijon:

“Ne, Primus Albania SHPK, të cilët jemi titullarët e të drejtave ekskluzive të Programit Kompjuterik të Faturimit “J-Billing”, me adresë [...], autorizojmë Nexia Al Consulting SHPK [...] të dorëzojë një ofertë qëllimi i të cilës është të ofrojë shërbimet e ngjashme si ato që ofron Programi Kompjuterik “J-Billing” dhe më pas të negociojë dhe nënshkruajë kontratën nëse shpallet fitues.

Programi “J-Billing” është i regjistruar pranë Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit më datë 07.05.2015, me nr. 156 RDA, për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b.

Në këtë mënyrë ne ofrojmë garancinë tonë të plotë për produktin e ofruar nga ne në përputhje me këtë procedurë prokurimi.

Bashkëngjitur do të gjeni kopje të Certifikatës së Regjistrimit të së Drejtës së Autorit për programin kompjuterik të sipërcitur dhe kontratën e të Drejtave Ekonomike të Programit “J-Billing”.

2. Certifikatë Regjistrimi të Drejtë Autori, për z.K.Z, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Ministria e Kulturës për veprën me titull “J-Billing” nr. 156 RDA për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b.
3. Kontratë për Njohjen e të Drejtave Ekonomike të Programit “J-Billing”, e lidhur në datën 29.08.2022 ndërmjet palëve “Primus Albania” SHPK dhe z.K.Z.

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK ka paraqitur dokumentin Autorizim prodhuesi me datë 18.10.2023, lëshuar nga kompania “Primus Albania” SHPK për objektin e prokurimit: “Shërbim fiskalizimi” me nr ref- 83193-10-11-2023, drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër SHA, me anë të së cilit kompania Primus Albania SHPK, (të cilët janë titullarët e të drejtave ekskluzive të Programit Kompjuterik të Faturimit “J-Billing”), autorizojnë shoqërinë “Nexia AI Consulting SHPK” të ofrojë shërbimet e ngjashme si ato që ofron Programi Kompjuterik “J-Billing” dhe më pas të negociojë dhe nënshkruajë kontratën nëse shpallet fitues. Në këtë autorizim, jepen sqarime se Programi “J-Billing” është i regjistruar pranë Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit më datë 07.05.2015, me nr. 156 RDA, për kategorinë e veprave “Programe Kompjuterike”, neni 7/b, si dhe jepet garanci e plotë për produktin e ofruar, në përputhje me këtë procedurë prokurimi. Bashkëngjitur këtij autorizimi është Certifikata e Regjistrimit të së Drejtës së Autorit për programin kompjuterik të sipërcituar dhe kontrata e të Drejtave Ekonomike të Programit “J-Billing”. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se operatori Ekonomik ankimues ka paraqitur një autorizim prodhuesi për programin J- Billing ndryshe nga ajo që është kërkuar në dokumentat e tenderit, për fiskalizimin e faturave dhe integrim me sistemin e faturimit Al- Billing, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në dokumentat e tenderit objekt ankimimi, të publikuara në SPE në datën 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht që *operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA për kategorinë e veprës "Programe Kompjuterike", Neni 7/A, ose ekuivalente*, pra është lejuar që operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe dokumentacion ekuivalent me atë të kërkuar si në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit si më sipër cituar, kërkesë e cila është plotësuar nga shoqëria “Nexia AI Consulting” SHPK nëpërmjet Programit Kompjuterik “J-Billing”. Autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument lidhur me këtë fakt, pra pse programi i paraqitur nga ankimuesi nuk është ekuivalent me atë të kërkuar nga AK dhe nuk plotëson nevojat objektin e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83193-10-11-2023, me objekt: “*Sherbim fiskalizimi*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.
2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro